



# PROGRAMI KOMBËTAR I MONITORIMIT TË MJEDISIT 2023



TIRANË 2022

**PROGRAMI KOMBËTAR**  
**I MONITORIMIT TË MJEDISIT PËR VITIN 2023**

**Përgatitur nga:**

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit**

**Rruga “Sami Frashëri”**

**Godina Nr.4 Kati 2**

**Tel/Fax: +355 42 371 242/+355 42 371 237**

**Email: [info@akm.gov.al](mailto:info@akm.gov.al) [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)**

Programi u hartua nga Sektori i Kërkimit, Analizës dhe Bashkëpunimit Shkencor mbështetur nga Sektori i GIS, Informacionit dhe Regjistrave Mjedisore Mjedisorë, Sektori i Kimikateve, Sektori i Laboratorëve Teknologjisë dhe Infrastrukturës Mjedisore, Sektori i Vlerësimit të Gjendjes dhe Ndërgjegjësimit Mjedisor

**TIRANË 2022**

## **PËRMBAJTJA**

Lista e tabelave	
<b>KONSIDERATA TEORIKE</b>	<b>1</b>
<b>1.1</b> Mbrojtja e cilësisë së ajrit	<b>1</b>
<b>1.2</b> Zhurmat	<b>2</b>
<b>1.3</b> Mbrojtja e cilësisë së ujit	<b>2</b>
<b>1.4</b> Mbetjet	<b>3</b>
<b>1.5</b> Mbrojtja e peizazhit dhe biodiversiteti	<b>4</b>
<b>1.6</b> Mbrojtja nga ndotja industriale	<b>5</b>
<b>1.7</b> Mbrojtja nga kimikate	<b>5</b>
<b>1.8</b> Ndryshimet klimatike	<b>6</b>
<b>1.9</b> Koherenca me politikat kombëtare dhe strategjitë e tjera	<b>7</b>
<b>1.10</b> Metodologjia e analizimit	<b>7</b>
<b>1.11</b> Treguesit për monitorim	<b>7</b>
<b>1.12</b> Treguesit mjedisorë që duhen të raportohen në Agjencinë Europiane të Mjedisit	<b>20</b>
<b>2. ANEKSE</b>	<b>23</b>
<b>2.1</b> Rrjeti i monitorimit të ajrit	<b>23</b>
<b>2.2</b> Rrjeti i monitorimit të zhurmave	<b>23</b>
<b>2.3</b> Stacionet e monitorimit për lumenjtë	<b>25</b>
<b>2.4</b> Stacionet e monitorimit për liqenet	<b>33</b>
<b>2.5</b> Stacionet e monitorimit për lagunat	<b>36</b>
<b>2.6</b> Stacionet e monitorimit për detet/ujërat larës	<b>42</b>
<b>2.7</b> Stacionet e monitorimit të ujërave larës	<b>46</b>
<b>2.8</b> Stacionet e monitorimit për matjen e treguesëve biologjikë dhe ekologjikë të ujërave të brendshëm	<b>48</b>
<b>2.9</b> Stacionet e monitorimit për ujërat nëntokësorë	<b>50</b>
<b>2.10</b> Stacionet e monitorimit për tokën	<b>49</b>
<b>2.11</b> Stacionet e monitorimit të pyjeve	<b>51</b>
<b>2.12</b> Stacionet e monitorimit për biodiversitetin	<b>55</b>
<b>2.12.1</b> Monitorimi i shpendëve migratorë	<b>59</b>
<b>2.12.2</b> Tipet e habitateve natyrore të komuniteteve me interes, konservimi i të cilëve kërkon krijimin e zonave të veçanta për ruajtje dhe monitorim	<b>60</b>
<b>2.12.2.1</b> Habitata bregdetare dhe halofitike	<b>60</b>
<b>2.12.2.2</b> Duna ranore bregdetare dhe duna me shtrirje në brendësi të kontinentit	<b>61</b>
<b>2.12.2.3</b> Habitata të ujërave të ëmbla	<b>61</b>
<b>2.12.2.4</b> Shqopishte dhe kaçubishte të zonave me klimë të moderuar	<b>62</b>
<b>2.12.2.5</b> Shkorretë me lloje sklerofil	<b>62</b>
<b>2.12.2.6</b> Formacione natyrore dhe gjysëmnatyrore të kullotave	<b>62</b>
<b>2.12.2.7</b> Kënetat, Tokat me baltë dhe moçalishtet	<b>63</b>
<b>2.12.2.8</b> Habitata shkëmbore dhe shpella	<b>63</b>
<b>2.12.2.9</b> Habitata pyjore	<b>63</b>
<b>2.13</b> Lista e Florës Shqiptare me interes për Bashkimin Evropian pjesë e Direktivës së Habitaveve (92/43/eec)	<b>64</b>
<b>2.13.1</b> Të dhëna për speciet e pranuar ose të propozuara nga IUCN, në Listën e Kuqe të Florës Shqiptare	<b>65</b>
<b>2.13.2</b> Lista e Florës dhe Faunës së Egër të Shqipërisë sipas statusit të kërcënimit	<b>70</b>
<b>2.14</b> Zonat me përqëndrime të larta të kimikateve dhe metaleve të rënda në Shqipëri	<b>81</b>
Referencat	<b>82</b>

## Lista e tabelave

<b>Tabela I.</b> Masat për forcimin e inspektimit dhe kapaciteteve monitoruese	<b>2</b>
<b>Tabela II.</b> Frekuenca e zbatimit të monitorimit të gjendjes së ujërave sipërfaqësore	<b>3</b>
<b>Tabela III.</b> Plani i Veprimit për mbetjet dhe vendet e ndotura me NOQ	<b>5</b>
<b>Tabela IV.</b> Menaxhimi i NOQ dhe mbrojtja e mjedisit, ushqimit dhe biodiversitetit	<b>6</b>
<b>Tabela 1.</b> Indikatorët mjedisorë të kategorizuar sipas Gjendjes, Ndikimit dhe Trysnisë	<b>9</b>
<b>Tabela 2.</b> Treguesit mjedisor sipas DSPIR	<b>20</b>
<b>Tabela 3.</b> Indikatorët mjedisorë që duhet të raportohen në Agjencinë Europiane të Mjedisit	<b>21</b>
<b>Tabela 4.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese të zhurmës sipas qyteteve	<b>24</b>
<b>Tabela 5.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese të ujërave sipërfaqësorë sipas lumenjve	<b>25</b>
<b>Tabela 6.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese për ujërat sipërfaqësorë sipas liqeneve/rezervuareve	<b>34</b>
<b>Tabela 7.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese për ujërat sipërfaqësorë sipas lagunave përkatëse	<b>37</b>
<b>Tabela 8.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese për ujërat sipërfaqësorë të deteve	<b>39</b>
<b>Tabela 9.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese për ujërat larës	<b>42</b>
<b>Tabela 10.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese të cilësisë biologjike dhe ekologjike për ujërat e brendshme	<b>46</b>
<b>Tabela 11.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese për ujërat nëntokësorë	<b>48</b>
<b>Tabela 12.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese për tokën	<b>50</b>
<b>Tabela 13.</b> Shpërndarja e stacioneve monitoruese për erozionin në tokat Pyjore	<b>51</b>
<b>Tabela 14.</b> Shpërndarja e sipërfaqeve monitoruese për llojin e pishave mesdhetare	<b>51</b>
<b>Tabela 15.</b> Shpërndarja e sipërfaqeve provë të monitorimit për llojin e pishës së zezë	<b>51</b>
<b>Tabela 16.</b> Shpërndarja e sipërfaqeve provë të monitorimit për llojet e tjerë halorë	<b>52</b>
<b>Tabela 17.</b> Shpërndarja e sipërfaqeve të monitorimit për llojin ah	<b>52</b>
<b>Tabela 18.</b> Sipërfaqet provë të rrjetit të monitorimit për llojin dushk dhe gështenjë	<b>52</b>
<b>Tabela 19.</b> Shpërndarja e sipërfaqeve të monitorimit për llojin ah	<b>53</b>
<b>Tabela 20.</b> Shpërndarja e llojeve drurore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje	<b>54</b>
<b>Tabela 21.</b> Stacionet monitoruese për biodiversitetin	<b>56</b>
<b>Tabela 22.</b> Lista e specieve të shpendëve migratorë të propozuar për monitorim në lagunat dhe zonat lagunare të Shqipërisë	<b>59</b>
<b>Tabela 23.</b> Rrjeti i monitorimit/Sipërfaqet monitoruese të shpendëve migratorë	<b>60</b>
<b>Tabela 24.</b> Përhapja e habitateve bregdetare dhe halofitike në Shqipëri	<b>60</b>
<b>Tabela 25.</b> Përhapja e habitateve të dunave ranore dhe dunave bregdetare me shtrirje në brendësi të kontinentit në Shqipëri	<b>61</b>
<b>Tabela 26.</b> Përhapja e habitateve të ujërave të ëmbla në Shqipëri	<b>61</b>
<b>Tabela 27.</b> Përhapja e habitateve me shqopishte dhe kaçubishte të zonave me klimë të moderuar në Shqipëri	<b>62</b>
<b>Tabela 28.</b> Përhapja e habitateve me shkorretë me lloje sklerofile në Shqipëri	<b>62</b>
<b>Tabela 29.</b> Përhapja e habitateve me formacione natyrore dhe gjysëmnatyrore të kullotave në Shqipëri	<b>62</b>
<b>Tabela 30.</b> Përhapja e habitateve me moçalishte dhe ligatina në Shqipëri	<b>63</b>
<b>Tabela 31.</b> Përhapja e habitateve shkëmbore dhe shpella në Shqipëri	<b>63</b>
<b>Tabela 32.</b> Përhapja e pyjeve sipas llojit në Shqipëri	<b>63</b>
<b>Tabela 33.</b> Lista e florës Shqiptare me interes për Bashkimin European	<b>64</b>
<b>Tabela 34.</b> Shpjegimi i kategorisë së rrezikut sipas IUCN	<b>64</b>
<b>Tabela 35.</b> Lista e Florës dhe Faunës së Egër në Shqipëri	<b>65</b>
<b>Tabela 36.</b> Lista e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri	<b>77</b>

**Tabela 37.** Magazinat e kimikateve në vend, lloji i kimikateve që ato kanë të depozituar **80**

**Tabela 38.** Zonat me përqëndrime të larta të kimikateve dhe metaleve të rënda **80**

### **Lista e figurave**

**Figura 1.** Harta e shpërndarjes së stacioneve të monitorimit për indikatorët mjedisorë në territorin e Shqipërisë.....**8**

## Akronimet dhe njësitë

<b>AKM</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
<b>AKZM</b>	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
<b>AMBU</b>	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
<b>As</b>	Arsenik
<b>BE</b>	Bashkimi European
<b>C<sub>6</sub>H<sub>6</sub></b>	Benzeni
<b>Ca</b>	Kalcium
<b>Cd</b>	Kadmium
<b>CEMSA</b>	Consolidation of the Environmental Monitoring Sistem in Albania
<b>CO</b>	Monoksidi i karbonit
<b>Cu</b>	Bakër
<b>DCBD</b>	Konventa për Diversitetin Biologjik
<b>DDPSIR</b>	Forcat shtytëse, Trysnia, Gjendja, Impakti dhe Përgjigjia
<b>DDT</b>	Diklordifeniltrikloretani
<b>DKU</b>	Direktiva në Kuadër të Ujit
<b>DRM</b>	Drejtoria Rajonale Mjedisit
<b>ERR</b>	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
<b>GES</b>	Gazeve me Efekt Serrë
<b>HCB</b>	Hekzaklorbenzeni
<b>Hg</b>	Mërkur
<b>ISHP</b>	Instituti i Shëndetit Publik
<b>K</b>	Kalium
<b>KDB</b>	Konventa mbi Diversitetin Biologjik
<b>LNP</b>	Lëndës së ngurtë pezull
<b>Mg</b>	Magnez
<b>MIE</b>	Ministria Infrastrukturës dhe Energjitikës
<b>MM</b>	Ministria Mbrojtjes
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>MTM</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<b>N<sub>2</sub></b>	Azoti organik
<b>Na</b>	Natrium
<b>NBO</b>	Nevoja Biologjike për Oksigjen
<b>Ni</b>	Nikel
<b>NKO</b>	Nevoja kimike për Oksigjen

<b>Ni</b>	Nikel
<b>NKO</b>	Nevoja kimike për Oksigjen
<b>NO<sub>2</sub></b>	Dyoksidit i azotit
<b>NOQ</b>	Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm
<b>O<sub>2</sub></b>	Oksigjeni
<b>O<sub>3</sub></b>	Ozoni
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>PAH</b>	Hirokarbure aromatike policiklike
<b>Pb</b>	Plumb
<b>PCB</b>	Bifenilet e poliklorinuara
<b>PCB / PCT</b>	Poliklorbifenilet dhe poliklortrifenilet të poliklorinuara
<b>PCDD/PCFF</b>	Dibenzo-p-dioksinat dhe dibenzo-p-furanet e poliklorinuara
<b>PKMCA</b>	Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit
<b>PKMM</b>	Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit
<b>PM</b>	Grimcat e ngurta
<b>PO<sub>4</sub><sup>3-</sup></b>	Fosfatet
<b>P<sub>total</sub></b>	Fosfori total
<b>QA/QC</b>	Quality Assurance/Quality Control
<b>QTTB</b>	Qendra Transferimit të Teknologjive Bujqësore
<b>SHGJSH</b>	Shërbimi Gjeologjik Shqiptarë
<b>SO<sub>2</sub></b>	Dyoksidi i squfurit
<b>TBT (C<sub>4</sub>H<sub>9</sub>)<sub>3</sub>Sn</b>	Tributiltin
<b>TDS</b>	Totali i lëndëve të ngurta të tretura
<b>TSS</b>	Totali i lëndëve të ngurta pezull
<b>UBT</b>	Universiteti Bujqësor i Tiranës
<b>UN</b>	Ujërat Nëntokësore
<b>UNFCCC</b>	Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
<b>US</b>	Ujërat Sipërfaqësore
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>VOC</b>	Hirokarbureve volatile policiklike
<b>Zn</b>	Zink

## HYRJE

### KONSIDERATA TEORIKE

Monitorimi i mjedisit është një sistem, i cili nëpërmjet paraqitjes së treguesve mjedisorë, vlerëson kushtet mjedisore, ndotjen nga aktivitetet e subjekteve operuese si edhe studion tendencat mjedisore. Monitorimi mjedisor, mbështetet në zhvillimin e politikave dhe zbatimin e tyre, sigurimin e informacionit të vazhdueshëm për raportimin tek politikëbërësit kombëtarë, forumet ndërkombëtare dhe publikun. Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit përfshin treguesit për analizën e mostrave të ajrit, zhurmës, tokës, ujërave sipërfaqësor e nëntokësor, sipërfaqet pyjore dhe biodiversitetin. Bazuar në VKM-së nr. 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton çdo vit Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, si mjet i vlerësimit të gjëndjes dhe cilësisë së mjedisit në tërësi. Të dhënat e monitorimit pas përpunimit, paraqiten në Raportin e Gjendjes së Mjedisit të vitit respektiv.

Monitorimi mjedisor bazohet në zbatimin e metodologjisë **DSPIR** e cila përbën një rrjet analizash të mundshme për të zhvilluar strategjitë menaxhuese në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Monitorimi kryhet sipas disa kriterëve shkencore përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizës së mostrave, në mënyrë tradicionale si dhe me anë të përdorimit të sensorëve automatikë (*insitu*) (biosensorëve) deri dhe në përcjelljen e të dhënave në kohë reale (*on line*) në largësi (*remote monitoring*).

### 1.1 Mbrojtja e cilësisë së ajrit

Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit, bazuar në VKM-në nr. 594, datë 10.09.2014, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit” synon përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit në Shqipëri për një periudhë afatgjatë, duke sjellë uljen e rrezikut të efekteve serioze në shëndetin publik dhe mjedisit në tërësi. Kjo strategji siguron, hapa për bashkërendimin dhe zbatimin e legjislacionit aktual me atë europian.

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, bazuar në VKM-në nr. 412 datë 19.06.2019 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Cilësinë e Ajrit” është një instrument planifikimi për zbatimin e Ligjit Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit të Mjedisit”. Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit (PKMCA) përgatitet dhe zbatohet, kur nivelet e dyoksidit të squfurit (SO<sub>2</sub>), dyoksidit të azotit (NO<sub>2</sub>), benzenit (C<sub>6</sub>H<sub>6</sub>), monoksidit të karbonit (CO), plumbit (Pb), lëndës së ngurtë pezull (LNP) ose ozonit (O<sub>3</sub>) në ajrin e mjedisit, kalojnë vlerat kufi apo vlerat e synuara respektive.

Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2014 “Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”, ky plan ndjek dy objektiva:

- përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat ku janë tejkaluar limitet e vendosura me ligj, si dhe në zonat ku ekziston një risk i lartë i tejkalimit të këtyre limiteve;
- ruajtjen e nivelit të cilësisë së ajrit në pjesën e ngelur të territorit

Këto objektiva do të arrihen duke implementuar masa, për të mos lejuar dhe për të reduktuar shkarkimet nga trafiku, burimet industriale apo burimet difuze, me qëllim për t’iu përmbajtur limiteve të përcaktuara nga ligji. Vendimi nr. 352, datë 29.04.2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të” identifikon tri zona të ndryshme me nivele të ndryshme kritike të ajrit të mjedisit:



- Zona A, që përfshin aglomeratin e Tiranës dhe Elbasanit
- Zona B, që përfshin njësitë bashkiake të Fierit, Durrësit, Vlorës, Shkodrës, Korçës, Patosit, Ballshit, Kamzës dhe Paskuqanit,
- Zona C, që përfshin territorin e mbetur të vendit, ku ndodhen komunat që kanë një risk të ulët të tejkalimit të kufijve të ndotjes të përcaktuara me ligj.

**Tabela I.** Masat për forcimin e inspektimit dhe kapaciteteve monitoruese

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse	Afati	Treguesit/Synimet
<b>VI.I Modernizimi dhe përmirësimi i rrjetit të monitorimit</b>				
<b>VI.1.1</b>	Rishikimi dhe përshtatja e rrjetit të monitorimit të tanishëm	MTM AKM	2021-2025	Numri i stacioneve të mirëmbajtura dhe kalibruara
<b>VI.1.2</b>	Zbatimi i procedurave të kalibrimit me furnizimin e një kalibratori portativ (tub depërtimi dhe hollimi)	MTM AKM	2021-2025	Kalibrator portativ i blerë

## 1.2 Zhurmat

Plani Kombëtar i Veprimit për Menaxhimin e Zhurmës Mjedisore ofron një analizë të situatës aktuale, përgjegjësi institucionale, boshllëqeve ekzistuese ligjore dhe organizative. Ky plan parashikon masat e nevojshme për afatet kohore dhe vlerësimin e buxhetit të nevojshëm për të siguruar një menaxhim të mirë të ndotjes akustike.

Planet e veprimit për menaxhimin dhe zvogëlimin e zhurmës sipas kërkesave të Direktivës së Zhurmës 2002/49 / EC duhet të përgatiten pas vlerësimit të ndotjes akustike nga transporti rrugor, ajror dhe ujor.

## 1.3 Mbrojtja e cilësisë së ujit

Cilësia e ujërave është shumë domethënëse në një skemë monitoruese, pasi ujërat janë shpesh pasqyrimi i gjendjes së përgjithshme të gjithë pellgut ujëmbledhës. Një program monitorues i cilësisë së ujërave duhet të ketë gjithmonë parasysh tipin e përdorimit të tokës në pellgun ujëmbledhës, burimet dhe ndotësit që e shoqërojnë.

Lidhur me menaxhimin e ujit, ekzistojnë tre dokumente strategjike

- Strategjia Kombëtare e Burimit të Integruar të Ujit 2018-2027,
- Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017,
- Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 dhe plani i veprimit.

Qëllimi është të sigurohet menaxhim i integruar dhe funksional i burimeve ujore duke vendosur një sistem monitorimi dhe menaxhimi të rrezikut nga përmbytjet dhe pamjaftueshmërisë së burimeve ujore. Strategjia Sektoriale e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2019-2030 është në përgatitje e sipër dhe një nga objektivat kryesorë të saj është të sigurojë një mekanizëm të qartë dhe operacional për qëndrueshmërinë financiare të sektorit. Kjo strategji synon optimizimin e investimeve për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet, me qëllim shtrirjen dhe qëndrueshmërinë e sistemeve ujore, plotësimin e nevojave të kullimit, mbrojtjen e popullsisë dhe pronave nga përmbytjet. Programi i monitorimit për ujërat sipërfaqësorë mbulon statusin kimiko-fizik, mikrobiologjik, potencialin ekologjik, biodiversitetin dhe kushtet hidrodinamike.

AMBU përgjegjës kryesore për hartimin e Programeve të Monitorimit të Ujërave për basenet ujore propozojnë që monitorimi të kryhet sipas VKM-në nr. 1015, datë 16.12.2020, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet” monitorimi i statusit ekologjik dhe statusi kimik për ujërat sipërfaqësorë dhe ato nëntokësorë sipas kërkesave të Direktivës në Kuadër të Ujit, tabela përmbledhëse si më poshtë:

**Tabela II.** Frekuenca e zbatimit të monitorimit të gjendjes së ujërave sipërfaqësore

Elementët e cilësisë	Frekuenca vjetore e monitorimit			Frekuenca e monitorimit gjatë periudhës (2023-2028)	
	Lumenj	Liqene	Ujëra bregdetare	Monitorimi mbikqyrës	Monitorimi operacional
<b>Elementët biologjikë të cilësisë</b>					
Fitoplankton	Jo relevante	Çdo 3 muaj	çdo muaj	Të paktën 3 herë gjatë periudhës	Të paktën 3 herë gjatë periudhës
Fitobentos dhe makrofite ujore	1 herë në vit	1 herë në vit	Jo e domosdoshme	Të paktën 1 herë gjatë periudhës	Të paktën 2 herë gjatë periudhës
Makroalga	Jo e domosdoshme	Jo e domosdoshme	2 herë në vit	Të paktën 1 herë gjatë periudhës	Të paktën 2 herë gjatë periudhës
Invertebrorë bentikë	1 herë në vit	1 herë në vit	2 herë në vit	Të paktën 1 herë gjatë periudhës	Të paktën 2 herë gjatë periudhës
Peshq	1 herë në vit	1 herë në vit	Jo e domosdoshme	Të paktën 1 herë gjatë periudhës	Të paktën 2 herë gjatë periudhës
<b>Elementë fiziko-kimikë të cilësisë</b>					
Elementët e përgjithshëm fiziko-kimike	Të paktën çdo 3 muaj	Çdo 3 muaj	Çdo muaj	Të paktën 1 herë gjatë periudhës	Të paktën 2 herë gjatë periudhës
Ndotësit specifikë	Të paktën çdo 3 muaj	Të paktën çdo 3 muaj	Të paktën çdo 3 muaj	Të paktën 1 herë gjatë periudhës	Të paktën 1 herë gjatë periudhës
<b>Elementët hidromorfologjikë të cilësisë</b>					
Parametrat hidrologjikë	Në mënyrë të vazhdueshme	Në mënyrë të vazhdueshme	Në mënyrë të vazhdueshme	Në mënyrë të vazhdueshme	Në mënyrë të vazhdueshme
Parametrat morfologjikë	1 herë në vit	1 herë në vit	1 herë në vit	1 herë gjatë periudhës	Jo e domosdoshme

## 1.4 Mbetjet

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit 2020-2035 synojnë të sigurojnë udhëzime strategjike dhe të përcaktojnë një sërë masash për menaxhimin e integruar të mbetjeve duke pasqyruar praktikën më të mira të vendeve anëtare të BE-së. Kjo strategji është miratuar me Vendimin nr. 418, datë 27.5.2020, “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” të Këshillit të Ministrave.

Plani Sektorial Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, i quajtur ndryshe masterplani i mbetjeve, i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin nr. 1, datë 13.01.2020 ka përcaktuar një plan investimi me disa faza (2018-2032) për infrastrukturën lokale dhe rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin, transportin, riciklimin dhe pajisjet e trajtimit ose asgjësimit të mbetjeve.

Masterplani i mbetjeve, ka për qëllim përcaktimin e metodologjisë dhe teknologjisë për investimet e ardhshme në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, duke vlerësuar kostot dhe siguruar një sistem prioritarizimi objektiv, të verifikueshëm dhe transparent të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Të gjitha këto çështje duhet të monitorohen që të përgatiten ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale.

Plani Kombëtar i Veprimit për reduktimin dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ-ve) në bazë të VKM-së nr. 505, datë 29.08.2018 “Për miratimin e Planit Kombëtar të

veprimet për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ)” mbulon poliklorbifenilet dhe poliklortrifenilet të poliklorinuara (PCB / PCT), të cilat vlerësojnë gjendjen e mbetjeve dhe vendet e ndotura me NOQ. Në VKM nr. 360, datë 29.04.2015, ”Për miratimin e listës së Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm dhe përcaktimi i masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre” përcaktohet përfshirja në Programin kombëtar të Monitorimit të Mjedisit e të dhënave për NOQ-të. Planet e veprimet për menaxhimin e PCB-ve dhe krijimi i një sistemi për identifikimin, shënimin, heqjen, ruajtjen dhe asgjësimin përfundimtar të pajisjeve do të sjellë një përshkrim të nevojshëm për veprimet e eliminimit të NOQ-ve dhe identifikimit të pajisjeve me PCB/PCT në Shqipëri. Duke ndjekur kërkesat e direktivave për menaxhimin e integruar të mbetjeve do të duhet të monitorohen rrymat e mbetjeve si ambalazhet, mbetjet e pajisjeve elektrike e elektronike, bateritë dhe akumulatorët, makinat në fund të jetës, mbetjet bio, monitorimi i vend-depozitimeve të mbetjeve, etj.

### 1.5 Mbrojtja e peizazhit dhe biodiversitetit

Konventa mbi Diversitetin Biologjik (KDB) përcakton biodiversitetin si shkallën e variacionit të jetës. Ky ndryshim mund t'i referohet variacionit gjenetik, variacionit të llojeve ose ndryshimit të ekosistemit brenda një zone ose biome. KDB-ja ka tri objektiva kryesore, ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij dhe për ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që dalin nga shfrytëzimi i resurseve gjenetike dhe transferimi i teknologjive përkatëse. Vendim nr 31 datë 20.01.2016, “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit 2016-2020”, synon në nivel kombëtar, të kontribuojë në rritjen e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura, hartimin e Planeve të Menaxhimit si dhe zbatimin e tyre. Ky dokument ka të bëjë me hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit për parandalimin e humbjes së biodiversitetit, fragmentimit të habitateve, prerjet ilegale të pyjeve, ndalimin e gjuetisë si dhe harmonizimin dhe zbatimin e kornizës ligjore, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian. Ligji 68-2014 03.07.2014 Për disa shtresa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i cili synon mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik, përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritetit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve I edhe Të sigurojë ngritjen e rrjetit për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 9868, datë 04.02.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", përcakton kriteret për shpalljen e zonave të mbrojtura, si dhe njeh zona të veçanta të mbrojtura me interes për Komunitetin Evropian, fillimisht duke siguruar mundësinë për vlerësimin e habitateve me interes për Komunitetin Evropian të përfshira në shtojcat e Direktivës për Habitatet dhe pastaj të propozojë këto fusha në bazë të kriterëve të përcaktuara me ligj, në përputhje me Direktivën e Habiteteve. Mbrojtja e habitatit kryhet përmes dispozitave të ligjit për zonat e mbrojtura, në bazë të të cilit është vendosur rrjeti përfaqësues i zonave të mbrojtura që do të shërbejnë për të identifikuar dhe për të krijuar rrjetin ekologjik NATURA 2000. Ligji për mbrojtjen e faunës së egër parashikon dispozita mbrojtëse për habitate të rëndësishme për shpendët në përgjithësi dhe ato migratore në veçanti. Ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar, ka për qëllim ruajtjen/konservimin e faunës së egër, sikurse dhe mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e saj, me synimin për të siguruar llojet, popullatat, habitatet ku kjo faunë e egër jeton, rrugët e shtegtit, sikurse dhe kërkesat e saj për ushqim, strehim dhe shumim. “Lista e kuqe e florës dhe faunës së egër shqiptare është miratuar me Urdhër të Ministrit të Mjedisit nr 1280, date 20.11.2013 “Për miratimin e Listës së Kuqe të Florës dhe Faunës së Egër” e cila përmban 407 specie të Florës së Egër dhe 575 specie të Faunës së Egër të Shqipërisë. Paraqitur në aneksin 2.13.2, tabela 35.

Dokumenti i Politikës së Pyjeve 2019-2030 miratuar me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018, "Për pyjet" dhe VKM-së nr. 570 datë 17.07.2019 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve", ngarkojnë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve për vlarësimin e gjendjes së pyjeve nëpërmjet procesit të monitorimit që nga pikëpamja metodologjike mbështetet tek treguesit sasiorë të Kriteve për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve. Ligji nr.57 datë 30.04.2020 "Për Pyjet" ka për qëllim mbrojtjen e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

## 1.6 Mrojtja nga ndotja industriale

Strategjia e Minerave 2010-2025 synon zhvillimin e aktiviteteve minerare miqësore me mjedisin përmes zbatimit të masave zbutëse, proceseve të rehabilitimit mjedisor, forcimit të mbikëqyrjes dhe monitorimit, për të siguruar më pak ndotje duke zbatuar teknologji të përparuara që kanë efekte minimale në mjedis. Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e mjedisit" ka si qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Ngritja e strukturave të inspektim-kontrollit brenda Agjencisë Kombëtare të Mjedisit do të rrisë monitorimin e parametrave si dhe sasinë e informacionit që do të merret nga subjektet.

## 1.7 Mbrojtja nga kimikatet

Plani Kombëtar i Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) sipas VKM-së nr. 505, datë 29.08.2018 "Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ)" ka si objekt kryesor identifikimin e situatës së NOQ-ve, bifenilet e poliklorinuara (PCB) dhe trifenilet e poliklorinuar (PCT) në vend, si dhe azhurnimi i Planit Kombëtar të Veprimit, (2006) për të mundësuar përcaktimin e masave dhe strategjinë për zvogëlimin, ndalimin dhe eliminimin e NOQ-ve. Ky dokument ofron një vlerësim të gjendjes së inventarit aktual si edhe aspektet ligjore, institucionale dhe teknike.

Në zbatim të VKM nr. 505 datë 29.8.2018 "Për miratimin e planit Kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ)" parashikohet plani i veprimit si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela III.** Plani i Veprimit për mbetjet dhe vendet e ndotura me NOQ

Vlerësimi fillestar i gjendjes së mbetjeve me NOQ dhe vendet e ndotura		
Përshkrimi i masës	Institucion përgjegjës	Koha
Identifikimi i sipërfaqeve të ndotura, mostrim dhe analiza mostrash toke dhe gjaku për përcaktimin e nivelit të ndotjes në mjedis dhe shëndet	AKM dhe universitetet/Akademia, Insitute kërkimore UBT (Departamenti i Agromjedisit)	2019-2021

Bazuar në VKM nr. 360, datë 29.4.2015, "Për miratimin e listës së Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm dhe përcaktimi i masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre" përcaktohet që të dhënat për NOQ duhet të përfshihen në programin e monitorimit të mjedisit. Në këtë kontekst duhen të ndërmerren këto masa kryesore:

Monitorimi i NOQ në zona dhe mjedise të ndryshme si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Tabela IV. Menaxhimi i NOQ dhe mbrojtja e mjedisit, ushqimit dhe biodiversitetit

<b>Harmonizimi plotësimi dhe zhvillimi i ligjeve dhe akteve nëligjore për të vendosur monitorimin e komponimeve të NOQ-ve në të gjitha planet e veprimit të mjedisit, ushqimit dhe biodiversitetit</b>		
<b>Përshkrimi i masës</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Koha</b>
Miratimi i programit të monitorimit për substancat e NOQ në të gjitha aksionet dhe planet e veprimit të mjedisit.	MTM/AKM	2019
Përfshirja e monitorimit të NOQ veçanërisht të PCB-ve, si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit	MTM/AKM	2019
<b>Zbatimi i programit të monitorimit për kimikatet me përmbajtje të NOQ-ve në: ajër, ujë, det, tokë organizma biologjike dhe njeriu</b>		
Zbatimi i programit të monitorimit për kimikatet NOQ në ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe në venddepozitimet e mbetjeve.	MTM/ dhe AKM/ universitetet/ Akademia dhe institutet kërkimore	2020-2023
Implementimi i planit të monitorimit të tokës në afërsi të ish-zonave të ndotura	MTM/ dhe AKM/ universitetet/ Akademia dhe institutet kërkimore	2020-2023

Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe i produkteve plehëruese në bujqësi, janë tregues të presionit që ushtrohet në mjedis. Përveç funksionit pozitiv të mbrojtjes dhe rritjes së bimëve kanë edhe ndikim negativ në tokë dhe mjedis. Ujërat e vaditjes përmes rrjedhjes së tyre shkaktojnë ndotje të ujërave sipërfaqësore duke transportuar përmbajtje të kimikateve që vijnë si rezultat i përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe të produkteve plehëruese kimike.

Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve janë të përcaktuara magazinat e kimikateve të vjetra si dhe gjendjen e zonave të nxehta mjedisore (hotspot) në vendin tonë të cilat paraqiten në tabelat në aneksin 2.14, tabela 36, 37.

## 1.8 Ndryshimet klimatike

Dokumenti Strategjik për Ndryshimet Klimatike sipas Ligjit nr.155 datë 17.12.2020 "Për Ndryshimet Klimatike" krijon kuadrin e përgjithshëm Kombëtar për veprim ndaj ndryshimeve klimatike, pjesë përbërëse e së cilës është Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike. Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë përcakton masat kombëtare për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe shtimin e përthithësve të GES-it në sektorët përkatës. Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike krijon kuadrin për një proces të vazhdueshëm të përshtatjes në vend dhe përcakton objektivat për përshtatjen, nxit integrimin e përshtatjes në politikat sektoriale të ministrive të linjës, përcakton masat prioritare dhe organizon përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkëpunimit brenda proceseve të përshtatjes. Këto plane synojnë zbutjen e efekteve nga ndryshimet klimatike, forcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe bashkëpunimin ndërinstytucional për zbutjen e ndryshimeve klimatike, krijimin e sistemit të të dhënave, monitorimin, raportimin dhe verifikimin e inventarit vjetor të GES-ve, në përputhje me kërkesat e raportimit të Bashkimit Europian (BE) dhe Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) si dhe promovimin dhe ndërgjegjësimin për të ulur emetimet. Vendi ynë ka miratuar Raportin e parë dyvjeçar të përditësuar për Shqipërinë (Korrik 2021) i cili tregon angazhimin e vazhdueshëm të qeverisë për të marrë masa për ndryshimet klimatike në fushat dhe sektorët kryesorë. Komunikimi i Katërt Kombëtar për Ndryshimet Klimatike është në përgatitje e sipër, duke u përqëndruar në sektorët që shkarkojnë gaze serrë siç janë sektorët e transportit dhe industrisë, duke zhvilluar skenarë të ndryshimeve klimatike, vlerësime të rreziqeve që lidhen me klimën dhe përshtatjen me fokus biodiversitetin, burimet ujore, bujqësinë, pyjet,

popullsinë dhe shëndetin e popullatës për të gjithë rajonin bregdetar, që shërbejnë si bazë për raportimin në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Republika e Shqipërisë merr pjesë në skemën ndërkombëtare të tregtimit dhe shkarkimeve të GES-it, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, duke përshtatur mekanizmat ndërkombëtarë të ndryshimeve klimatike dhe udhëzuesit ndërkombëtarë që zbatohen për këtë qëllim.

## 1.9 Koherenca me politikat kombëtare dhe strategjitë e tjera

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030 synon zhvillimin e burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të larmishëm të energjisë bazuar në parimet e tregut, të aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqënies me kosto minimale sociale. Në lidhje me mjedisin, kjo strategji synon rritjen e teknologjisë ERR (për Burimet e Rinovueshme të Energjisë), përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese joefikase të energjisë, duke marrë parasysh ndikimin e saj në mjedis dhe në ndryshimet klimatike.

Shqipëria është palë nënshkruese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), të miratuar në “Samitin e Tokës në Rio” më 1992 dhe të ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më 1994, e cila ka përcaktuar objektivin për luftën kundër ndryshimeve klimatike përmes stabilizimit të përqëndrimeve të GES-ve në atmosferë dhe kufizimit të rritjes së temperaturave mesatare globale për të përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm. Shqipëria ka nisur procesin e ndryshimit të statusit nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar, në kuadrin e KKKBNK-së. Procesi është pjesë thelbësore e procesit të integritimit në BE dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të Gazeve me Efekt Serrë (GES-ve), formulimin dhe zbatimin e politikave për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve, përshtatjen me ndryshimet klimatike, si dhe transpozimin dhe zbatimin e tërësisë së legjislacionit të BE-së për ndryshimet klimatike.

## 1.10 Metodologjia e analizimit

Institucionet monitoruese të cilat përfshijnë institutet, laboratorët, qendrat kërkimore-shkencore, universitetet publike dhe institutet e laboratorët private të licencuar, kontrahohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Institucionet që realizojnë monitorimin e treguesve konkrete të dukurive natyrore të cilësisë së përbërësve të mjedisit si ajri, uji, toka dhe biodiversiteti duhet të përdorin metoda të vlefshme dhe të akredituara, të cilat përfshijnë metodat e matjes në vendin e marrjes së mostrës, shpeshinë e njësive të matjes, mënyrën e përcaktimit, përpunimit dhe paraqitjes së të dhënave.

Projektet e institucioneve monitoruese shërbejnë si bazë për konkurrimin dhe për lidhjen e kontratave të monitorimit.

## 1.11 Treguesit për monitorim

Treguesit kryesore të gjendjes, të ndikimit dhe të trysnisë në ajër, në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, në tokë, në zonën bregdetare, në detet, pyjet e në larminë biologjike janë të përcaktuara sipas VKM-së nr. 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtarë të Monitorimit të Mjedisit”, të cilat janë të paraqitura në tabelën nr.1 ndërsa treguesit mjedisore të cilët janë në përputhje me treguesit e përdorur nga Agjencia Europiane e Mjedisit janë të paraqitura në tabelën nr.2. Stacionet kombëtare të cilat janë paraqitur në tabelat më poshtë sipas zonave dhe treguesve mjedisorë që do të monitorohen, janë përcaktuar nga projekti CEMSA ‘Consolidation of the Environmental Monitoring System in Albania, 2010-2013’ (<http://cemsaproject.net/home>) (EuropeAid/128449/C/SER/AL – IPA 2008).

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit 2023




Figura 1. Harta e shpërndarjes së stacioneve të monitorimit për indikatorët mjedisorë në territorin e Shqipërisë

Klasifikimi	Emri (treguesi mjedisor)	Vendi i kampionimit	Shpeshtësia	Përpunimi dhe paraqitja e të dhënave	Institucioni përgjegjës për monitorimin	Institucioni përgjegjës për regjistrim
Ndryshimet klimatike	<b>B.TREGUESIT MJEDISOR TË GJENDJES</b>					
	a) temperatura mesatare e ajrit;	Rrjeti kombëtar i stacioneve metereologjike	Ditore	Përpunim statistikor	Subjekti fitues në tender	MTM AKM
	b) niveli i detit	Shëngjin, Vlorë				AKM
	c) sasia e reshjeve atmosferike;	Rrjeti kombëtar i stacioneve metereologjike	2 herë në vit	Përpunim statistikor	SHGJSH	
	ç) niveli ujërave nëntokësore	40 stacione në 6 basene Sipas aneksit 9				
	<b>C. TREGUESIT MJEDISOR TË NDIKIMIT</b>					
	a) prirja e ndryshimeve në kohë për të gjithë treguesit B1;		Vjetore	Përpunim statistikor	Subjekti fitues në tender	AKM
	b) ndryshime fenologjike		Vjetore	Përpunim statistikor, Paraqitje tabelare	Subjekti fitues në tender	AKM
	<b>Ç. TREGUESIT MJEDISORË TË TRYSNISË</b>					
	a) Sasia vjetore e shkarkimit të CO <sub>2</sub> , NOX dhe CH <sub>4</sub>		Vjetore	Përpunim statistikor	Subjekti fitues në tender	AKM
b) Shpërndarja e shkarkimeve të CO <sub>2</sub> , NOX dhe CH <sub>4</sub> për sektorë të ndryshëm të ekonomisë si energji, transport, administrim i mbetjeve, bujqësi, industri.		Vjetore	Përpunim statistikor,	Subjekti fitues në tender	AKM	
Preçipitimet atmosferike	<b>B.TREGUESIT MJEDISORË TË GJENDJES</b>					
	a) përmbajtja e dioksidit të squfurit, SO <sub>2</sub>	Pranë rrjetit të stacioneve Metereologjike (9 Pika)	Stinore	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	Subjekti fitues në tender	AKM
	b) përmbajtja e oksideve të azotit, NOX	Stacionet Metereologjike				
	c) përmbajtja e plumbit, Pb					
	ç) radioaktiviteti në precipitimet atmosferike					
<b>C.TREGUESIT MJEDISORË TË NDIKIMIT</b>						
Dukuria e aciditetit në mjedis	a) përmbajtja e joneve sulfate në liqene	Ohri, Shkodër, Butrint, Prespa Tabela 6	Stinore	Paraqitja tabelare	Subjekti fitues në tender	AKM
Ajri urban	<b>B.TREGUESIT MJEDISOR TE GJENDJES</b>					
	a) përmbajtja e lëndës së ngurtë pezull në ajër;	Tabela 3	16 ditë në muaj		AKM; MTM; ISHP; MSHMS; MIE	AKM
	b) përmbajtja e ozonit, O <sub>3</sub> , në ajër;		24 orë/ditë 30 ditë/muaj			
	c) përmbajtja e plumbit, Pb, në ajër;		Mujore			
ç) përmbajtja e dioksidit të squfurit SO <sub>2</sub> , në ajër;	24 ore/ditë 30 ditë/muaj					



d) përmbajtja e oksideve të azotit, NO <sub>x</sub> , në ajër;		24 orë/ditë 30 ditë/muaj	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	AKM ISHP MIE	AKM
dh) përmbajtja e monoksidit të karbonit , CO në ajër		24 orë/ditë			
e) përmbajtja e hidrokarbureve në ajër;		24 orë/ditë			
ë) niveli i zhurmave	Tabela nr. 4 Tiranë, Elbasan, Korçë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier, Sarandë, Kukës, Pogradec, Berat, Lezhë, Gjirokastër	Javore për çdo muaj		ISHP, MSHMS MIE/AKM AKM	AKM
f) radioaktiviteti në atmosferë		Përmbajtja e PM10/PM2.5; 16 ditë në muaj per pajisjet manual dhe 30 ditë në muaj për pajisje automatike			
g) rrezatimi elektromagnetik jo jonizues në atmosferë					
h) Përmbajtja e PM <sub>10</sub> Përmbajtja e PM <sub>2.5</sub>		Javore për çdo muaj			
i) Përmbajtja e aerosoleve në ajër			QFBZ	AKM	
<b>Ç.TREGUESIT MJEDISORË TË TRYSNISË</b>					
a) sasi të vjetore të shkarkimeve në qendrat urbane të SO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> , CO <sub>2</sub> , CO;	Sipas aktiviteteve, trafik rrugor, etj	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	Ministria e Mbrojtjes Personi fizik dhe juridik, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i lejes mjedisore	AKM
b) shpërndarja e shkarkimeve të SO <sub>2</sub> e NO <sub>x</sub> , sipas sektorëve të ekonomisë;					MTM AKM
c) sasia vjetore e elementëve të rëndë;					AKM
ç) sasia vjetore e radioaktivitetit të precipitimeve atmosferike ;			Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	MB për objektet e saj Subjekti fitues në tender	AKM
d) vëllimi vjetor i precipitimeve	Stacionet Meteoreologjike				
Burimet e ndotjes që shkarkojnë në ajër					
a) inventari i tyre, sasi të vjetore të shkarkimeve CO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> , CH <sub>4</sub> , NH <sub>3</sub> , SO <sub>2</sub> , shkalla e errësimit të tymit, kompozimet organike, volatile, dioksina, furani, metalet e rënda në përgjithësi;	Sipas aktiviteteve, Trafik rrugor, etj	Çdo vit	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	Projekti "Për Ndryshimet Klimatike" MTM Personi fizik dhe juridik, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i lejes mjedisore	AKM
b) shpërndarja sektoriale e shkronjes 'a' për sektoret e industrisë, energjisë, transportit dhe shërbimeve.	Sipas aktiviteteve, Trafik rrugor, etj	Çdo vit	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	MIE	AKM
<b>B.TREGUESIT MJEDISORË TË GJENDJES</b>					

<b>Ujërat sipërfaqësore (lumenjtë liqenet)</b>	a) alkaliniteti;	Tabela 5; 6; 7	Stinore për liqenet dhe dy mujore për lumenjtë	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare/ grafike.	AKM	AKM
	b) konduktivitetit elektrik;					
	c) aciditeti					
	ç) përmbajtja e nevojës kimike për oksigjenin, NKO					
	d) përmbajtja e nevojës biokimike për oksigjen, NBO					
	dh) përmbajtja e komponimeve të azotit, N-NO <sub>2</sub> , N-NO <sub>3</sub>					
	e) përmbajtja e fosforit, P-PO <sub>4</sub> , P-total					
	ë) përmbajtja e amoniumit, N-NH <sub>4</sub>					
	f) vlera e pH					
	g) vlera e fonit radioaktiv natyror dhe radioaktiviteti i ujërave;					
	gj) qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjëve					
	h) treguesit bakteriale					
	j) Transparenca (oksigeni i saturuar), ngopshmëria me oksigjen					
	k) Lënda pezull					
	l) Oksigjeni tretur					
	4 herë në vit për çdo lumë					
	Stinore					
m) Metalet e rënda: Hg, Pb, Cd, As, Cu	4 herë në vit					
<b>C.TREGUESIT MJEDISORË TË NDIKIMIT</b>						
a) cilësia dhe sasia e prurjeve të ngurta, pezull dhe fundore të lumenjve	Tabela 5	Jo më pak se 4 herë në vit	Paraqitje tabelare dhe grafike	Subjekti fitues në tender	AKM	
b) erozioni i shkaktuar nga lumenjtë		2 herë në vit për çdo lumë	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare			
c) qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve;		2 herë në vit për çdo lumë				
ç) tejkalimet e normave të cilësisë së treguesve të pikës B4.1.		Vjetore				
<b>C.TREGUESIT MJEDISORË TË TRYSNISË</b>						
a) Cilësia dhe sasia e prurjeve të ngurta, pezull dhe fundore të lumenjve		Jo më pak se 4 herë në vit	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	Subjekti fitues në tender	AKM	
<b>Det dhe bregdeti B.TREGUESIT MJEDISORË TË GJENDJES</b>						
a) temperatura	Tabela 7; 8; 9	Stinore	Përpunim statistikor		AKM	

b) pH			Paraqitja tabelare	Subjekti fitues në tender	
c) Saliniteti					
ç) Transparenca					
d) Oksigjeni i tretur					
dh) Përmbajtja P-PO4, P-totale					
e) Përmbajtja e komponimeve të azotit N-NO2, N-NO3					
ë) Përmbajtja e amoniumit N-NH4					
i) nevoja kimike për oksigjen NKO					
j) nevoja biokimike për oksigjen NBO5					
k) parametrat mikrobiologjike për ujërat e plazheve		Maj-Shtator (çdo 2 javë)			
l) sasia e fito dhe zooplanktonit		Stinore			
ll) përmbajtja e klorofilit dhe prodhimtarisë primare		Stinore			
m) përmbajtja në midhjet e ujërave detare të metaleve të rënda, ndotësve, organikë të qëndrueshëm, radioaktivitetit		Çdo javë gjatë periudhës së grumbullimit dhe 2-3 muaj në vit për pjesën tjetër			
n)radioaktiviteti i ujërave		Stinore	Përpunim statistikor	Subjekti fitues në tender	AKM
nj) ujëkëmbim det-lagunë		Mujore (1 herë/ 3 vjet)	Paraqitja tabelare		
r) dinamika e deltave të lumenjve		Sezonale (në prurje min. max)(1 herë/ 3 vjet)			
rr) morfologjia dhe topografia e shelfit detar		Mujore (1 herë/ 3 vjet)			
t) morfologjia e bregdetit.					
<b>C.TREGUESIT MJEISORË TË NDIKIMIT</b>					
a)lëvizja e vijës bregore, erozioni dhe akumulimi	Lumenjtë kryesore Drin, Mat, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë				
b)ujë-këmbimi det-lagunë	Lagunat Kune - Vain, Patok, Nartë, Karavasta				
c)dinamika e deltave të lumenjve	Lumenjtë kryesore Drin, Mat, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë	Sezonale (në prurje min. max) (1 herë/ 3 vjet)	Përpunim statistikor Paraqitja tabelare	MIE SHGJSH	AKM
ç) shkalla e ekspozimit të popullsisë ndaj ndotjes mikrobiologjike dhe kimike, të plazheve.		Vjetore		ISHP	
d) tejkallimet e normave të cilësisë së treguesve të pikës B4.2				Subjekti fitues në tender ISHP	

<b>Ujërat nëntokesore</b>	<b>B.TREGUESIT MJEDISORË TË GJENDJES</b>					
